VENDIM
Nr. 324, datë 31.5.2018

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT NR. 2 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT SUEDEZ NR. TF014255, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA SUEDIA, E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SIDA), PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 2 të marrëveshjes së grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
BERZH-IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

5 mars 2018

Sh.t. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Ref.: Granti nr. TF014255
Grandi Suedez për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes për Shqipërinë
Ndryshimi nr. 2 i letërmarrëveshjes

Shkëlqesi,

I referohemi letërmarrëveshjes (Marrëveshja) së datës 30 maj 2013 ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) që vepron si administratore e fondeve të grandit të dhënë nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA) (Donator) dhe Republikës së Shqipërisë (Përfitues), i ndryshuar.

Ne u referohemi, gjithashtu, diskutimeve të fundit ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore. Si rrjedhojë, Marrëveshja ndryshohet si më poshtë:

1. Seksioni 2.02 i shtojcës së marrëveshjes ndryshohet duke fshirë fjalët "Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) dhe zëvendësimin e tyre me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ose çdo pasues të tij."

2. Tabela e seksionit 3.01 e shtojcës së marrëveshjes ndryshohet dhe zëvendësohet në tërësinë e saj me tekstin e mëposhtëm:

Kategoria	Shuma e Grantit të Alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke zbritur taksat)
1) Mallrat (përveç mallrave për pjesën 3(c) të projektit), shërbimet e konsulentëve, trajnimeve, shërbimeve teknike dhe shpenzimeve operative shtuese për projektin	3 955 000	100%
2) Mallrat për pjesën 3(c) të projektit	339 000	55%
SHUMA TOTALE	**4 294 000**	

Për qëllimet e këtij seksioni, "Shpenzimet operative shtuese" janë shpenzimet e arsyeshme shtuese administrative të MBZHR-së të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, pajisjeve, orendive, materialeve dhe furnizimeve, shpenzimet e komunikimit dhe shpenzimet për karburantin gjatë udhëtimeve në terren.

Seksioni 3.03 i shtojcës së marrëveshjes ndryshohet dhe zëvendësohet në tërësinë e vet me tekstin e mëposhtëm:

"3.03 ***Periudha e tërheqjes***. Data e mbylljes e referuar në seksionin 3.06(c) e kushteve standarde është 31 maj 2019".

Të gjithë termat dhe kushtet e Marrëveshjes, përveç kur ndryshohen nëpërmjet kësaj letërmarrëveshjeje, mbeten tërësisht në fuqi.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e përfituesit për ndryshimin e mësipërm, duke nënshkruar, vendosur datën dhe kthyer te ne kopjen bashkëlidhur kësaj letre ndryshimi. Kjo letër ndryshimi hyn në fuqi në datën në të cilën Banka Botërore i dërgon Përfituesit njoftimin e marrjes së njoftimit të Përfituesit për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi sipas legjislacionit të Përfituesit.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga (*nënshkrimi*)
Maryam Salim
Menaxher Vendi
Zyra e Bankës Botërore, Tiranë,
Republika e Shqipërisë

RËNË DAKORD:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: *(nënshkrimi)*
Përfaqësues i Autorizuar
Emri: Arben Ahmetaj
Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Datë 21.5.2018